



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-0/DPK	Nr. Prot. B. Prot. 01-1811/15
Nr. llog. Broj stranica 02	Data Datum 06-07-2015
KOSHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.07.2015, mori:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02/863/15, për z. Besim Beqaj, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, ne ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë të ardhur në adresë të AKK-së, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-02/863/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë, z. Besim Beqaj, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në informatën e marrë është dyshuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka një biznes (zyre konsulente) i cili funksionon në ndërtesën e Odes Ekonomike të Kosovës.

Duke vepruar sipas kompetencave dhe mandatit që kemi, janë grumbulluar informatat zyrtare të ofruara nga ARBK-ja, është krahasuar formulari për deklarimin e pasurisë, dokumente zyrtare të ofruara nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe janë ndërmarr veprimet e parapara sipas rregullores së punës së AKK-së.

Agjencia kundër Korrupsionit ka vlerësuar informatat dhe provat zyrtare të siguruar nga institucionet kompetente, dhe ka ardhur në përfundim dhe konstaton se : z. Besim Beqaj, deputetë i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk ka të regjistruar biznes me më emër “Menagment Consulting and Development - MCD” Sh.P.K, në ARBK-ë,ashtu siq dyshohet.

Biznesi me emër “Menagment Consulting and Development - MCD” Sh.P.K, është në pronësi të znj. Yllka Beqaj, gruas së z. Besim Beqaj dhe ka si persona të autorizuar znj.Yllka Beqaj dhe Veton Beqaj.

Zyrtari i lart z. Besim Beqaj, në formularin e deklaramit të pasurisë të dorëzuar në Mars 2015 ka të deklaruar të hyra për bashkëshorten e tij nga biznesi.

Posedimi i një biznesi nga anëtarët e familjes të zyrtarit të lart nuk është i ndaluar dhe nuk paraqet mos pajtueshmëri në ushtrim e funksionit publik, derisa zyrtari i lart nuk është i përfshirë në menaxhimin dhe udhëheqjen e biznesit, gjatë kohës sa ushtron funksion publik e që mundë të sjell situatë të konfliktit të interesit të paraparë me ligjin Nr.04/L-051.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi si dhe me faktet e grumbulluara lidhur me këtë rast mundë të themi se nuk kemi elemente të gjendjes së konfliktit të interesit të paraparë sipas Ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

